



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 999 prot.

Tiranë, më 25.10.2021

VENDIM

Nr.125, datë 25.10.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 43, DATË 25.06.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 43, datë 25.06.2020, “Mbi përfundimin verifikimit të ligjshmërisë, në lidhje me zbatimin e aktit nr. 2181 datë 20.05.2020 të DAP , për nëpunësin *****”.

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 510 prot., datë 5.6.2020, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimin se, nga ana e institucionit Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, nuk veprohet për zbatimin e aktit të Departamentit të Administratës Publike, me anë të të cilit është urdhëruar rikthimi i nëpunësit në fjalë, në pozicionin e mëparshëm të punës si “Kryeinspektor në ISHPSHSH, Dega Rajonale Tiranë”, pas mbarimit të afatit të transferimit të përkohshëm 6-mujor në pozicionin “Kryeinspektor në ISHPSHSH, Dega Rajonale Elbasan”.

Për verifikimin e këtij rasti, Komisioneri, me shkresën nr. 510/1 prot., datë 12.6.2020, “Kërkohet informacion në lidhje me zbatimin e aktit të DAP për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës të punonjësit *****”, drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i ka kërkuar shpjegime njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, në lidhje me shkakun e krijimit të kësaj situatë paligjshmërie.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr. 43, datë 25.06.2020, *“Mbi përfundimin verifikimit të ligjshmërisë, në lidhje me zbatimin e aktit nr. 2181 datë 20.05.2020 të DAP , për nëpunësin *****”*, në të cilin është vendosur:

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, me shkresën nr. 510/8 prot., datë 09.07.2020, *“Kthim përgjigje”*, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues,

duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin Nr. 43, datë 25.06.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri ka kërkuar nga titullari i institucionit Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, kryerjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të aktit nr. 2181, datë 20.5.2020, të Departamentit të Administratës Publike, duke kthyer nëpunësin ***** në pozicionin e tij të punës *“Kryeinspektor në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale Tiranë”*.

Konstatohet se, me aktin nr. 1006/1 prot., datë 06.07.2020, *“Mbi përfundimin e periudhës së transferimit të përkohshëm për nëpunësin *****”*, titullari i institucionit, në zbatim të vendimit paralajmërues të Komisionerit, ka vendosur kthimin e nëpunësit në pozicionin e mëparshëm të punës, në përputhje me Ligjin Nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 43, datë 25.06.2020, *“Mbi përfundimin verifikimit të ligjshmërisë, në lidhje me zbatimin e aktit nr. 2181 datë 20.05.2020 të DAP , për nëpunësin *****”*.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA